

# UNIMARC SMALTO SETA

MBROJTËS AKRILIK PA AROMË I HOLLUESHËM ME UJË SATIN PËR SIPËRFAQE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME

seri 300

## PËRSHKRIMI

UNIMARC SMALTO SETA është një produkt i hollueshëm me ujë, me cilësi të lartë me bazë rezinë akrilike në dispersion ujor dhe pigmente ngjyrues me qëndrueshmëri të lartë ndaj dritës. Rezinat akrilike, nga të cilat përbëhet, i sigurojnë produktit rezistencë të shkëlqyer ndaj agjentëve atmosferike, rezistencë të lartë ndaj zbehjes dhe mbulim, shtrirje të mirë dhe aderim/vendosje në lloje të ndryshme sipërfaqesh.

UNIMARC SMALTO SETA është pa aromë dhe nuk ndizet/merr flakë, dhe për këtë arsye rezulton veçanërisht i përshtatshëm për aplikimin në ambiente të brendshme pak të ajrosur.

Si të gjithë produktet e linjës UNIMARC rezultojnë lehtësisht i aplikueshëm dhe shumë i shpejtë në tharje.

UNIMARC SMALTO SETA është i përshtatshëm për finitura të cilësisë së lartë në sipërfaqe të jashtme dhe të brendshme hekuri, fletë metalike të xinguar (galvanizuara), lidhje të lehta, druri, plastike dhe sipërfaqe murale të brendshme.

## UDHËZIME PËR PËRDORIMIN

I aplikueshëm në:

- sipërfaqe druri të reja ose të lyera;
- sipërfaqe hekuri dhe detale hekuri, nëse paraprakisht janë të trajtuara përshtatshëm;
- sipërfaqe të xinguar (galvanizuara), alumini dhe lidhje të lehta;
- sipërfaqe në material plastik (PVC);
- sipërfaqe murale të brendshme

KINI KUJDES në trajtimin e druve të pasur me taninë. Për të reduktuar formimin e shenjave/njollave të errëta aplikoni astarin izolues UNIMARC PRIMER ANTITANNINO kod. 3080001/0019.

## KARAKTERISTIKA TEKNIKE

- Natyra e lidhësit: kopolimer akrilik në dispersion ujor
- Solventi: ujë
- Dendësia UNI EN ISO 2811-1: 1,10-1,35 kg/l në bazë të ngjyrës.
- Rezistenca në larje UNI 10560: e shkëlqyer, >10000 cikle
- Shkëlqimi UNI EN ISO 2813: 25-30, këndi i leximit 60°

- Viskoziteti UNI 8902: 2000 ± 300 cps. në 25 °C (viskozimetër rrotullues Brookfield).

-Tharja: (25 °C e 65% U.R.): prekja pas 3 orësh, Shtresa tjetër pas 6 orësh.

## PËRGATITJA E SIPËRFAQES

### Sipërfaqe hekuri dhe detale hekuri:

-Hiqni me pastrim mekanik ose manual pjesët e galvanizuara jo të mirë aderuar dhe ndryshkun, duke ushtruar presion mesatar..

-Hiqni shtresat e bojës së vjetër jo mirë të aderuar dhe zmeriloni të gjithë sipërfaqen.

-Hiqni vajrat nga sipërfaqja me holluesin diluent.

-Eliminoni plotësisht pluhurat dhe ndotjet.

-Në sipërfaqe të thara mirë, aplikoni MARCOTECH AU METAL PRIMER 3320807.

-Në sipërfaqe veçanërisht të ekspozuara ndaj agjentëve atmosferikë, aplikoni 1-2 shtresa astar kundër ndryshkut PRIMER 1630307.

-Aplikoni 2 shtresa UNIMARC SMALTO SETA.

### Sipërfaqe të xinguar (galvanizuara), alumini dhe lidhje të lehta:

-Hiqni shenja të oksidimit me pastrim mekanik ose manual.

-Hiqni vajrat nga sipërfaqja me solucione alkaline ose me diluent.

-Eliminoni shtresat e bojës së vjetër jo të mirë aderuar dhe zmeriloni të gjithë sipërfaqen për ta ashpërsuar.

-Hiqni pluhurat dhe, në sipërfaqe të thara shumë mirë, vazhdoni me aplikimin e MARCOTECH AU METAL PRIMER 3320807 në zonat që ishin me ndryshk.

-Në sipërfaqe veçanërisht të ekspozuara ndaj agjentëve atmosferikë, aplikoni 1-2 shtresa astar monokomponent PRIMER kod. 1630307.

-Aplikoni 2 shtresa UNIMARC SMALTO SETA.

### Sipërfaqe në material plastik (PVC):

-Zmeriloni sipërfaqen për ta ashpërsuar pak.

-Hiqni vajrat nga sipërfaqja me holluesin diluent dhe pastroni sipërfaqen.

-Në sipërfaqe të pastra dhe të thara aplikoni 2 shtresa UNIMARC FONDO UNIVERSALE seri 335.

-Pas të paktën 6 orësh aplikoni 2 shtresa UNIMARC SMALTO SETA.

### Sipërfaqe në dru:

-Zmeriloni lehtësisht për të larguar fibrat e ngritura të drurit.

-Eliminoni shtresat e ngritura të bojës së vjetër dhe ashpërsoni të gjithë sipërfaqen e lyer.

# UNIMARC SMALTO SETA

MBROJTËS AKRILIK PA AROMË I HOLLUESHËM ME UJË SATIN PËR SIPËRFAQE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME  
seri 300

-Hiqni rezinën e pranishme duke përdorur holluesin dylient të përshtatshëm.  
-Stukoni parregullsitë me stuko sintetike. Zmeriloni stukimet dhe eliminoni pluhurin.  
-Aplikoni, në sipërfaqe të tharë dhe të pastër, 2 shtresa UNIMARC FONDO UNIVERSALE seri 335, në interval kohor prej 6 orësh ose bojë opake si sfond MARCONOL ORIENTALITE 1450519.  
-Vazhdoni me aplikimin e 2 shtresave të UNIMARC SMALTO SETA.

## Sipërfaqe në suva, gips dhe kartonxhes:

-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë dhe tërësisht e maturuar. Nëse është e nevojshme siguroni konsolidim me produkte specifike.  
-Në prani të mykut, trajtoni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 kod. 4810222 dhe me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes).  
-Hiqni, me zmerilim ose me ujë me presion mesatar, mykun present dhe pluhurat e bojës së vjetër. Eliminoni komplet shtresat e ngritura të bojës në gëlqere ose temperave.  
-Hiqni smogun, pluhurat dhe çdo ndotje tjetër me zmerilim mesatar.  
-Niveloni parregullsitë e sipërfaqes dhe trajtoni çarjet, plasaritjet dhe uljet me TAMSTUCCO 9400006/9410110; zmeriloni stukimet dhe çarjet me letër zmerile.  
-Ngjisni çarjet me ngjitës (stuko) adekuat.  
-Mbushja e çarjeve, plasaritjeve mund të realizohet me RASAMIX 9440160 ose me BETOMARC 9450150 ose me RASOMARC 9500150 në bazë të llojit të sipërfaqes.  
-Në sipërfaqe të pastra dhe të thara aplikoni një shtresë astar akrilik me bazë uji IDROFIS 4700006 ose astar të mikronizuar solvent free ATOMO 8840001. IDROFIS 4700006. Në kartonxhes aplikoni astarin specifik që pigmentoset PREPARA 4710019. Në prani të spesorëve/trashësisë së ulët të temperave të vjetra ose bojrave të pluhurosura, një shtresë astar me solvent ISOMARC 4410111 ose astar të mikronizuar solvent free ATOMO 8840001.  
-Vazhdoni me aplikimin e UNIMARC SMALTO SETA.

\* (Hollimi i astarit dhe sasia për t'u aplikuar janë në funksion të absorbimit të sipërfaqes dhe përcaktohen me prova paraprake në sipërfaqe specifike. Konsultohuni me skedën teknike përkatëse).

## UDHËZIME PËR APLIKIM

Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes:  
Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +35 °C  
Lagështira relative e ambientit: <75%  
Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +35 °C  
Lagështira e sipërfaqes: <10%  
-Mjetet: pinel, rrul dhe pistoletë.  
-Në aplikimet me pinel dhe rrul aplikohet siç është ose hollohet max me 5% ujë.  
-Në aplikimet me pistoletë hollohet me ujë 10-15%.  
-Nr shtresave: të paktën 2 shtresa.  
-Shkalla e mbulimit: 6-7 m<sup>2</sup>/l me 2 shtresa, me spesor/trashësi prej 40 mikron.  
-Pastrimi i mjeteve bëhet menjëherë pas përdorimit, me ujë.

## NGJYROSJA

Ngjyrosja realizohet nëpërmjet Sistemit Tintometrik Marcromie dhe me kolorantët COLORADO seri 548.  
Në rast të përdorimit të fabrikimeve të ndryshme është e këshillueshme të përzihen midis tyre produktet e ndryshme për të shmangur ndryshime në tonalitete.

## MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30 °C  
Temperatura minimale e ruajtjes: +5 °C  
Produkti preferohet të përdoret brenda 3 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

## UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)  
Kat. B: bojë për mure dhe tavane të brendshëm (shkëlqimi  $\geq 25 @ 60^\circ$ )  
(bazë Uji): 150 g/l (2007) / 100 g/l (2010)  
Kat. D: bojë për finitura dhe veshje (rivestimenti) të brendshme/jashtme druri dhe metali (bazë uji): 150 g/l (2007) / 130 g/l (2010)  
UNIMARC SETA Përmban max: 100 g/l VOC

Produkti nuk kërkon etiketim sipas D.L. 65 të 14/03/03 dhe modifikimeve/ azhornimeve.  
Përdoreni produktin sipas normave aktuale të higjienës dhe sigurisë; pas përdorimit mos l hidhni mbetjet në ambient,

# UNIMARC SMALTO SETA

MBROJTËS AKRILIK PA AROMË I HOLLUESHËM ME UJË SATIN PËR SIPËRFAQE TË JASHTME  
DHE TË BRENDSHME

seri 300

I lini të thahen dhe I trajtoni ato si mbetje të vecanta. Mbajeni larg përdorimit nga fëmijët. Përdoreni në vende të mirë ventiluara. Në rast të kontaktit me syte, lajini menjëherë me ujë të bollshëm.

Në rast të gëlltitjes, konsultohuni menjëherë me mjekun dhe i tregoni enën ose etiketën.

Mos I hidhni mbetjet/ambalazhet në kanalizime, terren.

Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

## SPECIFIKIMET

Mbrojtës akrilik i hollueshëm me ujë, satin, për sipërfaqje të brendshme-jashtme.

Aplikimi, në sipërfaqje të predispozuar, për smalto të hollueshëm me ujë, pa aromë, satin UNIMARC SMALTO SETA seri 300, me bazë rezinë akrilike në dispersion uxor dhe pigmente ngjyrues me rezistencë të lartë ndaj dritës, në të paktën 2 shtresa, me një konsum minimal prej 140 ml/m<sup>2</sup>.

Furnizimi dhe instalimi i materialit € .....  
për m<sup>2</sup>.

*SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti i produktit. Skeda e paraqitur anullon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.*